



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Datë: 18.03.2026

Mbledhja e pestë (5) e Qeverisë së Republikës së Kosovës mbahet më 19.03.2026, në orën 11:00, ndërtesa e Qeverisë, sala P-31.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e Zyrës për çështjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, e cila vepron në kuadër të ZKM-së, në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (ZKM)
2. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për Themelimin dhe Funkcionimin e Sistemit për Zbatimin e Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Kosovën përmes Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor (ZKM)
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, dhënien e autorizimit për Ministren e Drejtësisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale, me Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës (MD)
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për përditësimin e Listës Shtetërore Strategjike për Mallra me Përdorim të Dyfishtë, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike, ose për arsye të të drejtave të njeriut (MINTI)
5. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Shëndetsisë për pagesën e 55 (pesëdhjetepesë) specialistëve me vetëfinancim nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe transfere" (MSh)
6. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Shëndetsisë për pagesën e 37 (tridhjeteshtatë) specialistëve me vetëfinancim nga Lugina e Preshevës, Mali i Zi etj., nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe transfere" (MSh)
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim dhe krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik të pronave të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Linja ajrore 110kV, parku me Erë - Zatriqi 1&2" (MMPH)

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave të Reformës së Administratës Publike dhe strukturave përgjegjëse për të koordinuar, monitoruar dhe zbatuar dokumentet strategjike të Reformës së Administratës Publike (MDAP)
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e përshtatjes së ndarjeve buxhetore, sipas Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive (MF)
10. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Financave për dhënien në shfrytëzim të ngastrave kadastrale për Doganën e Kosovës (MF)
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit: “Ndërtimi i Qendrës për Sport dhe Kulturë”, Komuna Ferizaj (MMPH)
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore KBI Ereniku, për nevoja të realizimit të Projektit “Ndërtimi i Zonës Industriale të Mbrojtjes” (MMPH)
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale M25, Prishtinë – Podujevë (MMPH)
14. Shqyrtimi i Draftit të Raportit për Vlerësimin Ex-Post të Ligjit Nr.08/L-250 për Ndryshime Klimatike (ZKM)
15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve buxhetore për Fondin e Ekselencës (MF)
16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për mandatit Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut (ZKM)
17. Të ndryshme